



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2025:039483
Datë: 28.03.2025
Numri i dokumentit: 07060817

PML.nr.192/2025

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Bashkim Hyseni anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit Samuel Krasniqi, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, 2025:039483 datë 28.02.2025 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.DP.nr.343/2025 datë 11.03.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit Samuel Krasniqi, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, 2025:039483 datë 28.02.2025 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.DP.nr.343/2025 datë 11.03.2025.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin 2025:039483 e datës 28.02.2025, të pandehurit Samuel Krasniqi, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë

trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK, ndërsa i pandehuri Samuel Kukelaj për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të KPRK, ua ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji, nga data 26.02.2025 e deri me datën 28.03.2025. Masa e paraburgimit iu është caktuar konform dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. 1 dhe 2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.DP.nr.343/2025 të datës 11.03.2025, i ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Samuel Krasniqi av. Meshari Selimaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën-par. 2.7 të KPP-së, nenit 432 par. 1, nën-par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, nenit 415 par. 1 nën-par. 1.1, 1.2 lidhur me nenin 184 par. 1 nën-par. 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit dhe i njëjti të mbrohet në liri ose nën masën e arrestit shtëpiak.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.III.nr.81/2025 e datës 17.03.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se në aktvendimet e kundërshtuara vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore për caktimin e masës së paraburgimit pa i specifikuar ato në mënyrë konkrete dhe më detajisht, nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme për ekzistimin e dyshimit të bazuar dhe bazave ligjore të veçanta për caktimin e kësaj mase. Mbrojtësi thekson se i pandehuri gjersa po mbahej në qendrën e ndalimit në stacionin policorë, për shkak të një gabimi të ndodhur është liruar nga mbajtja, dhe pasi është kuptuar gabimi, është thirrur prindi i tij për ta kthyer djalin sërish. I pandehuri nga frika e reagimit të prindit është larguar pas rastit të ndodhur, mirëpo vullnetarisht është paraqitur, i dihet identiteti dhe adresa e saktë e vendbanimit, është i moshë së re, andaj nuk ekziston rreziku i ikjes apo arratisjes, po ashtu dëshmitarët dhe i dëmtuari janë dëgjuar dhe se nuk ka as rrezik të përsëritjes së veprës penale ngase prezenca e tij në vendin e ngjarjes ka qenë për të parandaluar fjalosjen në mes të F.B, dhe Samuel Kukelaj. Me lëshimet e përmendura, të pandehurit i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 415 të KPP-së, ashtu që vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore pa dhënë arsye të artikulueshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal 2025-EA-265 i datës 26.02.2025, aktvendimit për fillimin e hetimeve, PP/II.nr.251/2025 i datës 27.02.2025, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit, dëshmitarëve si dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën po hetohet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ngase procedura penale është në fazën e hetimeve dhe se i pandehuri nga data 20.02.2025 e deri me datën 26.02.2025 ka qenë në arrati, rrethanë që e bën të bazuar drojën se me lëshimin e të pandehurit që të mbrohet nga liria ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale e në këtë mënyrë do ta pamundëson zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ndikimit në të dëmtuarin dhe dëshmitarët, apo te i pandehuri tjetër që t'i koordinojnë deklaratat me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundëson zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprat penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vëren se me vendimin e ri, 2025:039483 datë 26.03.2025, të pandehurve iu është vazhduar masa e paraburgimit edhe për tridhjetë (30) ditë, duke u llogaritur nga data 28.03.2025 e deri me datën 27.04.2025 (vendimi është marrë me datën 26.03.2025), ky vazhdim është bërë në mënyrë jo të rregullt ngase vazhdimi i paraburgimit do të duhej të bëhej nga data 26.03.2025 e deri me datën 24.04.2025.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale në vendimet për caktimin e masës së paraburgimit, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja nga liria apo nën masën e arrestit shtëpiak, sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit nuk është masë adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr.192/2025, me datë 28.03.2025

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi